



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
NR. 3465/1 PROT
DAT 08/04/2026



BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

Nr. ____ Prot.

Korçë, më datë ____ . ____ .2026

Lënda: Shkresë përcjellëse

DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKIMET
SEKTORIT TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15 datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “Stimulimi i Industrive Kreative” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës”, konfirmuar për bazueshmërinë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresë nr. 165/1 prot. datë 08.02.2026 , Marrëveshjes nr. 1292 prot. datë 09.02.2026 midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë “Për financimin e projektit “**Stimulimi i Industrive Kreative**”, dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. ~~377~~, datë ~~08~~.04.2026 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe përzgjedhjen e shoqërisë që do të zbatojë projektin “Stimulimi i Industrive Kreative”; më anë të kësaj shkrese kërkojmë nga ana juaj të procedoni me afishimin e kësaj shpallje për bërjen me dije subjekteve të interesuar për procedurën e përzgjedhjes së shoqërisë që do të zbatojë projektin “Stimulimi i Industrive Kreative”.

Bashkangjitur njoftimi për afishim.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE

ANXHELA DISHNICA QERAMIXHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKIMET
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 3465 Prot.
2

Korçë, më datë 08/04 2026

NJOFTIM

**“SHPALLJE PËR PËRZGJEDHJEN E SHOQËRISË
QË DO TË NGARKOHET ME REZALIZIMIN E PROJEKTIT “STIMULIMI I INDUSTRIVE
KREATIVE”**

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Korçë nr. 15, datë 29.01.2026 “Për miratimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*” dhe përzgjedhjen e partnerit për zbatimin e këtij projekti në qytetin e Korçës” konfirmuar mbi bazueshmërinë ligjore nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresë nr. 165/1 prot., datë 08.02.2026, Marrëveshjes nr. 1292 prot. datë 09.02.2026 midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë “Për financimin e projektit “*Stimulimi i Industrive Kreative*”, dhe Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Korçë nr. 377, datë 08.04.2026 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe përzgjedhjen e shoqërisë që do të zbatojë projektin “*Stimulimi i Industrive Kreative*”; Bashkia Korçë njofton se të gjithë subjektet që janë të interesuara për realizimin e projektit “Stimulim i Industrive Kreative” duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik (shoqëria) i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (provuar me vendim gjykatë/dokument tjetër lëshuar sipas kërkesave të ligjit nga institucionet përkatëse);
- Të ketë përvojë të dokumentuar në zbatimin e projekteve për zhvillimin ekonomik lokal;
- Të krijojë mundësi për vetëpunësim dhe sipërmarrje të vogël;
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me artizanatin /zejtarinë ose fusha të ngjashme;
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura; (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi. (vertetim nga gjykata);
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë (çertifikatë e gjëndjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve artizanale (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë artizanale (diplomw, listpagesa. cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të projektit të **“Stimulimi i Industrive Kreative**, mënyrës si do asistojë dhe do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme lokale kombëtare dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut në fushën e artizanëve/zejtarëve;
- Të ketë minimum 5 vite eksperiencë në fushën e artizanatit/zejtarisë dhe prodhuesve kreative lokale.

KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë brenda **afatit 2 javor nga data e afishimit** dokumentacionin e kërkuar pranë **zyrës së Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur**. Vlerësimi i dokumentacionit do të bëhet në sallën e Mbledhjes, Kati i I, në dt 22.04.2026 në Bashkinë Korçë.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në numrin e telefonit [+35582243353]; në adresën e postës elektronike: info@bashkiakorçe.gov.al ose të vizitoni faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.

Kjo shpallje do të afishohet në stendën e Bashkisë Korçë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Korçë.

U shpall sot në Stendat e Bashkisë Korçë dt. 08/04/2026.

Sektori i Mardhënieve me Publikun _____

KRYETARI
Sotiraq Filo

